



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6679 Prot.

Roskovec, më 24, 12 2020

VENDIM

NR 91 .DATË 07 .12 .2020

**“PËR SHITJEN E PRONAVE TË PALUAJTSHME NË PRONËSI TË BASHKISË
ROSKOVEC, SIPAS PROGRAMIT “BANESË ME KOSTO TË ULËT”**

Në mbështetje të Kodi Civil nenet: 83, 705, 750 dhe 751; të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1.2 gërmat 'a' dhe 'c', neni 24 pika 2, neni 54 gërma 'e'; Ligji nr.8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, nenet 11 e 12; Ligjit nr.87441, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 8; të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" neni 13 pika 1 gërma 'b' paragrafi "iii", neni 16, gërma 'a' paragrafi 'vi' dhe gërma 'c' paragrafi 'ii', neni 44 pika 2, neni 49 pika 1; "; Akt normative nr. 3, datë 1.8.2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar” si dhe Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr. 35, datë 13.06.2016 “Rehabilitimi urban i tre blloqeve në bashkinë Roskovec”, nr.76 datë 18.10.2018 "Për miratimin e investimit për ndërtimin e një godine 3-katëshe për strehim social" dhe nr.28 datë 27.04.2020 "Rehabilitimi urban i bllokut nr. 1"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin për shitjen e pronave publike në pronësi të bashkisë Roskovec sipas certifikatës së pronësisë, hartës treguese dhe kartelave të pasurisë bashkëlidhur, pas zbatimit të programit “Banesë me kosto të ulët”.
- 2- Miratimin për shitjen e pronave publike, familjeve të cilat rezultojnë të pastreha si rezultat i zbatimit të projektit për interes publik "*Rehabilitimi urban i bllokut nr. 1*", banesat e të cilëve prishen për shkak të interesit publik, janë përjashtuar nga procesi i legalizimit dhe që nuk shpronësohen, konkretisht familjet banore të bashkisë Roskovec, si kategori me përparësi sipas Ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", neni 16, gërma 'a' paragrafi 'vi', me kryefamiljar:

1-Mitat Borici



2-Gramoz Hoxha

- 3- Miratimin për shitjen e pronave publike, familjeve të cilat rezultojnë të pastreha si rezultat i lirimit të banesës ish-pronarëve, si kategori me përparësi sipas Ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", neni 16, gërma 'c' paragrafi 'ii':

3-Rajmonda Cepele

4-Tajar Latifi

5-Sulejman Latifi

- 4- Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së këtyre pronave të paluajtshme nëpërmjet shitjes, do të bëhet me akt noterial dhe do të regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi.
- 5- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Juridike me zbatimin e këtij vendimi.
- 6- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska

